UDHËZIM
Nr. 21, datë 1.10.2012

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 4.9.2008 "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të dekretit të Presidentit nr. 7767, datë 1.10.2012 dhe ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme.

1. Pas pikës 2.7 "Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit" shtohet pika 2.8, me këtë përmbajtje:

"2.8 Taksa e ambalazheve njëpërdorimësh të plastikës dhe të qelqit

2.8.1. Në zbatim të neneve 3, 4, 5 dhe 8 te ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, taksa e ambalazheve një përdorimësh të plastikës dhe të qelqit aplikohet për produktet e përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit nr. 83/2012. Niveli i taksës së ambalazheve një përdorimëshe të plastikës është 100 lekë/kg, niveli i taksës së ambalazheve njëpërdorimëshe të qelqit është 10 lekë/kg, ndërsa vetëm për industrinë vendase të riciklimit, taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend, është 50 lekë/kg. Taksa e ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit aplikohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas.

Për ambalazhet njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit të importuara, importuesi e paguan taksën pranë degëve doganore ku është duke kryer procedurat e zhdoganimit.

Për ambalazhet njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit të prodhuara brenda vendit, prodhuesi paguan në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku është regjistruar, taksën për të gjithë sasinë e prodhuar, brenda datës 5 të muajit pasardhës. Prodhuesi duhet të plotësojë e të dorëzojë në drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar, formularin nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, duke deklaruar sasinë e prodhuar dhe duke i bashkëlidhur mandatpagesën për taksën e paguar.

2.8.2. Për qëllim të këtij udhëzimi dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "Ambalazh" është çdo material paketues që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund të mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë. Ai e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.

b) "Ambalazh njëpërdorimësh", për qëllime të këtij udhëzimi, do të konsiderohen ato ambalazhe që nuk i nënshtrohen regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë sipas nenit 161 të ligjit nr. 8449 datë 27.1.1999 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë" dhe pikave 3 dhe 4 të nenit 349 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.4.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar.

c) "Ambalazh plastik njëpërdorimësh" janë ambalazhet njëpërdorimëshe sipas përkufizimit të germës "b" më lart, dhe që klasifikohen në kodet tarifore 3923 dhe 392410 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në rastet kur importohet veçmas, dhe ambalazhet që ruajnë apo paketojnë mallrat e listuara në tabelën e dytë të aneksit 1 të ligjit nr. 83/2012 dhe zë të paktën 51% të masës së përgjithshme të ambalazhit.

ç) "Ambalazh qelqi njëpërdorimësh" janë ambalazhet njëpërdorimëshe sipas përkufizimit të germës "b" më lart dhe që klasifikohen në kodin tarifor 7010 dhe 392410 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në rastet kur importohet vecmas, dhe ambalazhet që ruajnë apo paketojnë mallrat e listuara në tabelën e dytë të aneksit 1 të ligjit 83/2012 dhe zë të paktën 80% të masës së përgjithshme të ambalazhit.

d) “TAN”, në kuptim të këtij udhëzimi, është shkurtimi i taksës së ambalazhit njëpërdorimësh.

2.8.3.Importuesi duhet të marrë masa që, vetë apo nëpërmjet kompanisë prodhuese apo eksportuese, të bëjë ndarjen e llojeve të ambalazhit të produkteve të importuara, për qëllimet e aplikimit të TAN. Në rast se nga ndarja rezulton që produktet përbërëse të ambalazhit sipas përkufizimit kategorizohen në germat “c” apo “ç”, atëherë importuesi është i detyruar të deklarojë TAN-in në deklarimin e tij dhe ta paguajë atë. Deklarimi i ambalazhit në DAV në import bëhet në nivel artikulli. Kur për të njëjtin artikull ka ambalazhe të ndryshme sipas kategorizimit të mësipërm, detyrimisht në DAV do të bëhet deklarimi i ndarë (me BIS) për artikujt me kod tarifor të njëjtë, por me kodifikim të ndryshëm ambalazhi në kutinë 31 të DAV.

2.8.4 Në rastet e importimit të ambalazheve njëpërdorimëshe të përdorur për importimin e produkteve të tabelave 2 të anekseve 1 dhe 2 të ligjit, nga pesha bruto përjashtohen paletat e drurit, të kartonit apo metalike.

Shembuj.

a) Në rast se në import paraqitet ambalazh plastik sipas kodeve tarifore të tabelës 1 të aneksit 1 të ligjit dhe plotësohen kushtet e germës “b” të pikës 1 të këtij udhëzimi, TAN zbatohet në bazë të peshës neto, duke aplikuar nivel taksimi 100 lekë/kg.

b) Në rast se në import paraqiten mallra në ambalazh qelqi sipas kodeve tariforë të tabelës 1 të aneksit 2 të ligjit dhe plotësohen kriteret e germës “c” të pikës 1 të këtij udhëzimi, TAN zbatohet në bazë të peshës neto duke aplikuar niveli taksimi 10 lek/kg.

c) Në rast se në import paraqiten mallra të klasifikuara në kodet tarifore të tabelës 2 të aneksit 1 të ligjit, në kutinë 31 të DAV përdoret kodi përkatës i paketimit, dhe TAN zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 100 lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV si peshe neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi.

ç) Në rast se në import paraqiten mallra të klasifikuara në kodet tarifore të tabelës 2 të aneksit 2 të ligjit, në kutinë 31 të DAV përdoret kodi përkatës i paketimit , dhe TAN zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 10 lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV si peshe neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi.

d) Në rast se në import, në të njëjtën ngarkesë, paraqiten mallra që janë edhe në tabelën 1 të aneksit 1 të ligjit, edhe në tabelën 1 të aneksit 2 të ligjit (pra ka edhe ambalazh plastik bosh edhe ambalazh qelqi bosh), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (pra me BIS); sistemi llogarit nivelin e taksës për çdo artikull sipas peshës neto përkatëse.

e) Në rast se në import, në të njëjtën ngarkesë, paraqiten mallra që janë edhe në tabelën 2 të aneksit 1 të ligjit, edhe në tabelën 2 të aneksit 2 të ligjit (p.sh. vaj vegjetal të kodeve 1507-1518 të ambalazhuara një pjesë në shishe plastike dhe një pjesë në shishe qelqi), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (pra me BIS), duke përdorur kode të ndryshme paketimi për sasitë respektive; sistemi llogarit nivelin e taksës për çdo artikull sipas diferëncës së peshës bruto me atë neto për cdo artikull.

f) Në rast se në import paraqiten mallra të ndryshëm nga kodet tarifore të listuara në tabelën e dytë të aneksit 1 dhe nga tabelën e dytë e aneksit 2 të ligjit 83/2012, por të ambalazhuara në ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi (p.sh. medikamente të kapitullit 30 të NK në ambalazh qelqi), atëherë për këto mallra nuk aplikohet TAN.

2.8.5 Për mallrat me ambalazhe njëpërdorimëshe plastikë apo qelqi, të prodhuara në vend, TAN do të paguhet në momentin e shitjes së mallrave, me faturë tatimore. Për efekt pagese, subjekti prodhues do të ndajë në faturën tatimore çdo shitje të mallrave sipas kapacitetit mbajtës të ambalazhit.

Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi, furnizohen nga subjekte që importojnë apo prodhojnë këto ambalazhe, kërkojnë nga prodhuesi apo importuesi, krahas faturës tatimore, dhe pagesën e TAN në organet tatimore apo doganore.

Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi, e prodhojnë vetë ambalazhin dhe e shesin atë për të tretë, do të paguajnë TAN për sasinë e shitur me faturë tatimore.

Çdo person juridik apo fizik, prodhues i ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit,

boshe për prodhimin e vet, si dhe çdo importues apo prodhues i ambalazheve boshe, në fund të çdo muaji do të deklarojnë stokun në organin tatimor ku është i regjistruar. Në rast të kundërt organet tatimore do të llogarisin TAN-in e këtyre ambalazheve për të gjitha shitjet e kryera për çdo muaj.

Në rastet e importimit të produkteve gjysmë të gatshme që përkojnë sipas kodeve të NK të përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit nr. 83/2012, të cilat janë qartësisht të destinuara për prodhimin e ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës apo qelqit të përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit nr. 83/2012, TAN paguhet në momentin e importimit, pavarësisht nëse importuesi është prodhues vendas dhe i importon këto produkte në funksion të aktivitetit të vet prodhues apo është importues i këtyre produkteve për qëllime tregtare.

2.8.6. Të gjitha subjektet prodhuese të ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit, brenda datës 30 tetor 2012 duhet të paraqesin pranë drejtorisë rajonale ku janë regjistruar, këto dokumente:

a) Licencë/leje/miratim nga institucioni përkatës, për prodhimin e produkteve njëpërdorimëshe të plastikës dhe qelqit;

b) Kopje të kartës teknologjike të prodhimit.

Çdo ndryshim i kartës teknologjike duhet t'i njoftohet organit tatimor një muaj përpara.

2.8.7 Taksa për ambalazhet të prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend, caktohet në masën 50 lekë/kg. Kjo taksë mblidhet nga administrata tatimore, në rastet kur mallrat sipas aneksit 1 të ligjit nr. 83/2012, paketohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh plastik të prodhuar nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Subjektet prodhuese të këtyre ambalazheve duhet të paraqesin pranë drejtorisë rajonale tatimore ku janë të regjistruar kopje të kartës teknologjike të certifikuar nga një institut/laborator i njohur. Në fund të çdo muaji, këto subjekte duhet të paraqesin kopje të deklaratave të importimit të lëndëve të para, si dhe dokumentimin e blerjeve të lëndëve të para brenda vendit. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të prodhuara nga riciklimi për qëllime përdorimi të ambalazheve.

2.8.8.Të gjithë tatimpaguesit të cilët kanë paguar pranë administratës doganore, akcizë për ambalazhet e plastikës dhe të qelqit sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar dhe kanë qenë të pajisur me autorizim si tatimpagues akcize dhe kanë pasur magazinë tatimore, në rast të shitjes së produktit (për të cilin është paguar akcizë në import) pas datës 1 tetor 2012 nuk janë subjekt i pagesës së TAN-it. Këta tatimpagues duhet që brenda datës 15 tetor 2012 të paraqesin pranë drejtorive rajonale ku janë të regjistruar, kopje të inventarit të ambalazheve për të cilat është paguar akciza. Administrata tatimore në bashkëpunim me administratën doganore kryejnë verifikimet rast pas rasti.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 tetor 2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode